

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditësit S.C.E.E.L. me seli në Londër, të cilin e përfaqëson avokati F. L. nga Prishtina, kundër të paditurit NTP “A.T.”, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së markës tregtare, vlera e kontestit e pa përcaktuar, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 16.09.2016, me datën, 16.09.2016, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

I. Miratohet kërkesëpadia e paditësit S.C.E.E.L., ashtu që vërtetohet se i padituri A.T., përmes importimit të produktit “Kabllo Av”, për lidhjen e televizorit me lojëra, në sasi prej 86 copë, ka bërë shkelje të markës tregtare “P.S.” të paditësit.

II. Urdhërohet i padituri që të bëjë shkatërrimin produktit si në pikën ”I” të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me shpenzimet e veta, në afatin prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Shkatërrimi i mallit të bëhet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

III. I ndalohet të paditurit në të ardhmen të importoj, ruaj apo të shes pa autorizim, mall me shenjë të njëjtë apo të ngjashëm me markën tregtare të paditësit, me mbishkrimin “P.S.”.

IV. Detyrohet i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale, në shumën prej 279.00 €, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

## **A r s y e t i m i**

### Rrethanat procedurale të çështjes

Paditësi S.C.E.E.L, me datën 13.03.2014, ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate, kundër të paditurit NTP “A.T.”. Në padi ndër të tjera ka theksuar se paditësi është pronar i markës së regjistruar tregtare “P.s.” me numër të regjistrimit *numër i regjistrimit...*, e cila është regjistruar me vendimet e MTI-së-Zyra për Pronësi Industriale, të datës. 16.10.2008. Markat “P.s.”-produkte nga teknologjia informative, dhe rekreative, është e mbrojtur në tërë territorin e Republikës së Kosovës. E paditura është shoqëri tregtare e cila si veprimtari afariste ka tregtimin e artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë, dhe se e njëjta ka tentuar të importoj 86 kabllo AV të cilat shërbejnë për ta lidhur aparatit e lojrave me televizor. Ka shtuar se malli i cili ka qenë i destinuar për tregun e Kosovës është ndaluar nga Dogana e Kosovës nën dyshimin e shkeljes së markës tregtare të paditësit. Me tej ka theksuar se pas marrjes së njoftimit nga Dogana e Kosovës, paditësi ka verifikuar se malli i cili është ndaluar në Doganë, nuk ka qenë i

prodhuar nga paditësit si bartës i Markës Tregtare ne Republikën e Kosovës. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka kontaktuar të paditurin të cilit i ka ofruar marrëveshje për shkatërrimin e mallit të lartpërmendur, por i padituri nuk është pajtuar. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim të vërtetoj se i padituri me importimin e kabllove e ka shkelur markën tregtare të paditësit, t'i ndalohet të paditurit që në të ardhmen të importoj apo të përdorë këtë produkt. Të urdhëroj shkatërrimin emallit të importuar dhe te detyrohet i padituri të mbuloj shpenzimet transportit ruajtjes dhe magazinimit të mallit të importuar.

Gjykata ka tentuar disa herë ta ftoj të paditurin për seancën përgatitore, sipas adresës në padi dhe sipas adresës pranë ARBK-së, por thirrja nuk ka mundur t'i dorëzohet për shkak se nuk është gjetur në adresat e lartcekura. Pastaj, gjykata ka ftuar të paditurin për seancë dëgjimore, përmes afishimit të thirrjes për seancë në tabelën e shpalljevetë kësaj gjykate, konform nenit 114 të LPK-së. Megjithatë, i padituri nuk është paraqitur në seancë dëgjimore dhe rrjedhimisht, gjykata ka mbajtur shqyrtimin kryesor në mungesë të të paditurit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 423 pika 4 e LPK-së.

Paditësi, gjatë seancave dëgjimore të mbajtura pranë kësaj gjykate ka deklaruar se qëndron pranë padisë dhe kërkesavetë sajë. Gjatë shqyrtimit kryesor e ka precizuar kërkesëpadinë në pikën II dhe ka kërkuar shkatërrimin e 86 kabllove Av, me mbishkrimin P.S. të cilat gjenden nën mbikëqyrjen e Doganës së Kosovës. Edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke e përfshirë edhe precizimine saj në seancën e datës 16.09.2016. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim ta miratojë kërkesëpadinë si të bazuar.

#### Gjendja faktike e konstatuar

Për të vërtetuar në mënyrë të saktë dhe të plotë gjendjen faktike gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës si në vijim: vendimet e Zyrës për Pronësi Industriale për regjistrimin dhe vazhdimin e markës tregtare “P.S.”; aplikacioni për vazhdim e regjistrimit të markës tregtare; lista e distribuimit e Doganës së Kosovës e datës 19.02.2014; fotografit A4 të kabllove, të ndaluara; dhe të dhënat për biznesin NTP “A.T.”.

Pas shqyrtimit dhe çmuarjes me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, dhe konstatimit të fakteve jo kontestuese, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Me vendimin ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, përkatësisht Zyrës së Pronësisë Industriale, me numër .... te dt.17.10.2011, është regjistruar si markë tregtare e paditësit, shenja “P.S.”, për produktin kablo dhe pajisje nga teknologjia informative.
- Me vendimin ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, përkatësisht Zyrës së Pronësisë Industriale, numër .... te dt.18.03.2014, është vazhduar marka tregtare “P.S.” produktet dhepajisje nga teknologjia informative.
- Nga dy vendimet e lartcekura, u vërtetua fakti se marka tregtare e paditësit “P.S.” është markë e mbrojtur në territorin e Republikës se Kosovë, me afat skadimi deri ne vitin 2019.

- E paditura e cila si veprimtari të saj afariste ka tregtimin e artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë, ka importuar 86 kablllo Av, të cilat shërbejnë për lidhjen e lojërave me televizor, më mbishkrimin P.S.. Kjo sasi e kablllove është ndaluar nga Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës për veprim të parashtruar nga paditësi, konform Ligjit mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale Nr.03/L-170.
- Nga provat e shqyrtuara gjykata ka vërtetuar faktin se kabllotqë janë objekt kontesti, përmbajnë mbishkrimin apo shenjën “P.S.” e cila shenjë është e mbrojtur si markë tregtaree paditësit, në Republikën e Kosovës.

### Baza juridike e kërkesëpadisë

Me dispozitat e nenit 4. par.1. të Ligjit për Markat Tregtare është përcaktuar se e drejta në markë tregtare fitohet përmes regjistrimit në regjistrin e markave tregtare që udhëhiqet nga Zyra për Pronësi Industriale, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës.

Ndërsa me dispozitat e nenit 8.1 të Ligjit për Markat Tregtare, është përcaktuar se marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij:

1.1. çdo shenjë, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare; dhe

1.2. çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asociimit së shenjës me markën tregtare.

Nga gjendje e vërtetuar si më sipër dhe konform dispozitave ligjore të cituara në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësit për mbrojtjen e markës tregtare, është e bazuar. Vënia në qarkullim - treg e produkteve “kablllo Av” të importuara nga Dubai të cilat shërbejnë për lidhjen e aparatit të lojërave me televizor, mund të shkaktojë konfuzionte konsumatorët, dhe të cenojë të drejtën e paditësit mbi markën tregtare “P.S.”. Gjykata vlerëson se mbishkrimi në kabllot e importuara me emërtimin “P.S. 2”, është shumë i ngjashëm me shenjën “P.S.”, e regjistruar si markë tregtare e paditësit. Ngjashmëritë janë të nivelit që mund të shkaktojnë shumë lehtëkonfuzion tek publiku. Po ashtu, mundësia e asociimit të produkteve të importuara me produktet e mbrojtura me markë tregtare, janë të nivelit të lartë.

Nga gjendje të vërtetuar faktike e vërtetuar si më sipër dhe konform dispozitave ligjore të cituara në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata konstatoi se kërkesëpadia e paditësit për mbrojtjen e markës tregtare, është e bazuar. Vënia në qarkullim - treg e produkt “KabllloAv” të importuara nga Dubai, do të shkaktoj konfuzionte konsumatorët, dhe do të cenon të drejtën e paditësit e cila i garantohet me markën tregtare të regjistruar, e cila gëzon mbrojtje ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se i padituri me importimin e produkteve “Kabllo Av”, ka shkelur markën tregtare të paditësit, dhe rrjedhimisht ka vendosur që të miratoj kërkesëpadinë e paditësit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### Shpenzimet procedurale

Gjithashtu, gjykata ka vendosur edhe për shpenzimet e shkaktuara në procedurë konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, ku palës paditëse i janë miratuar, shumat si në vijim: për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 €; për përfaqësim në seancë shuma prej 135 €; dhe shpenzimet për taksa gjyqësore për padi dhe aktgjykim në shumën prej 40.00 €, në shumën e përgjithshme prej 279.00 €.

**GJYKATA THEMELORE Në PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Ekonomike**  
**I.C.nr. 190/14, me datën 16.09.2016**

**Gjyqtari**  
**Bajram Miftari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të tij.